



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9210, DATË 23.03.2004,
“PËR STATUSIN E USHTARAKUT TË FORCAVE TË ARMATOSURA”, I
NDRYSHUAR**

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Dokumenti u publikua në RENJK në adresën “konsultimipublik.gov.al”, në datën 22.01.2025 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 19.02.2025, duke respektuar afatin ligjor të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

- **Me publikimin në RENJK** (<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/816>), u vendos një afat 22 ditor (ditë pune) për dhënien e sugjerimeve/komenteve mbi draftin e dokumentit.
- **Nëpërmjet adresës së emailit:** konsultim.publik@mod.gov.al:

Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas drafteve të projektligjit është vënë në dispozicion edhe një adresë elektronike.

- **Nëpërmjet adresës postare:** “Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë:

Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

• **Nëpërmjet zhvillimit të takimeve të drejtpërdrejta:**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Diskutimet lidhur me këtë projektligj janë zhvilluar gjatë takimeve në mbledhje grup pune.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projektakti janë:

- Ministria e Mbrojtjes;
- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura;
- Komandat e Forcave;
- Komandat Mbështetëse.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektligji është dërguar për mendim pranë:

- **Ministrisë së Financave**
- **Ministria së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**
- **Ministrisë së Drejtësisë**
- **Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin**

Projektligji i është dërguar për dijeni

- **Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.**

Komente të mbledhura gjatë fazës së konsultimit publik, për projektligjin e konsultuar nuk ka patur.

Komentet e ardhura nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera janë gjeneruar nëpërmjet sistemit eAkte.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
--	---	--	---	-------------

